



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me bashkëpropozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (kryetar)
- 2. Yllka Rupa*** (zëvendëskryetare)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Bledar Bajri*** (anëtar)
- 8. Albens Tabaku*** (anëtar)

9. *Markelian Koça* (anëtar)  
10. *Violanda Theodhori* (anëtar)  
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Artan Rama.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me bashkëpropozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Mirëmëngjesi të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas njoftimit të bërë dhe krijimit të kuorimit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme datë 31.10.2024, ora 10:00, me një rend dite të përcaktuar.

Keni diskutime mbi rendin e ditës?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me pikën e parë të tij që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me bashkëpropozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është përgatitur relacioni dhe relator do të jetë z. Kurushi. Fjala për ju.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit z. Kryetar!

Po prezantoj relacionin për projektvendimin mbi shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Bëj me dije kolegët që kjo është një projektvendim i ripërsëritur, pasi ne e kemi hapur një herë kërkesën e parë për shpalljen e këtyre kandidaturave në maj të vitit 2024, në maj të këtij viti dhe nuk morëm asnjë kërkesë apo shprehje interesi nga kandidatët.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të bërë të mundur realizmin e detyrimeve kushtetuese të parashikuar nga neni 147 të Kushtetutës dhe atyre ligjore që diktojnë ligjet e reformës në drejtësi, si një organ që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, përgjatë veprimtarisë së tij, ka detyrimin të miratojë një numër të madh aktesh administrative të natyrës normative, individuale, rregullore të brendshme e udhëzime jodetyruese.

Për të bërë të mundur këto detyrime që rrjedhin nga ligjet e reformës, duhet që të ekzistojë një strukturë organizative mirëfunktionale e tij dhe e administratës; duhet të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha njësive organizative dhe pozicioneve individuale; si dhe duhen edhe rregulla procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të tillë që të bashkëpunojë e bashkërendojë punën, për të siguruar mbështetje efikase dhe efektive për Këshillat dhe komisionet e tij.

Në funksion të detyrimeve që rrjedhin më lart, Këshilli ka miratuar me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 strukturën organizative të administratës, i ndryshuar me vendimin nr. 695, datë 21.11.2023, duke parashikuar në këtë strukturë ndër të tjera, Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Mbështetur në nevojat që ka Këshilli, në kushtet e disa procedurave të ngritjes në detyrë dhe të lëvizjeve paralele, për të pasur

3

kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale propozojnë që pranë Këshillit të komandohen 2 (dy) magjistratë, në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve ka në organikën e saj 7 (shtatë) pozicione nëpunësi përgjegjës për vlerësim, nga të cilët 5 (pesë) janë aktualisht të zëna dhe 2 (dy) pozicione janë vakante. Aktualisht të gjithë nëpunësit përgjegjës për vlerësimin kanë statusin e magjistratit. Për shkak të ecurisë së proceseve të vlerësimeve periodike 2017-2019, 2020-2022, 2021-2023, proceseve me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses rivlerësimin kalimtar, vlerësimet e detyruar të përsheptuara për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele, është urgjente plotësimi tërësisht i kësaj strukture. Prandaj, për të pasur kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, propozon që pranë kësaj njësie të komandohen edhe 2 (dy) gjyqtarë të tjerë.

Me vendimin nr. 262, datë 16.05.2024, Këshilli ndër të tjera vendosi:

“1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 2 (dy) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Në përputhje me parashikimet e pikës 11 të vendimit 262/2024, ku përcaktohet se: “Nëse asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk komandohet, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicioneve “Nëpunës përgjegjës për vlerësim”, komisionet iniciuese propozojnë rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 2 (dy) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Ky projektvendim mbështetet në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr.115/2016, nenet 8, 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016, si dhe në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005

“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Vlerësimet e Komisioneve:

Referuar nenit 54, pika 2 e Ligjit për Statusin, në një procedurë komandimi, Këshilli shpall kërkesën për kandidaturat, gjithmonë pasi të ketë bërë vlerësimin e nevojave, duke nënkuptuar nevojat e të gjithë sistemit ku ai bën pjesë. Në këtë rast, nga njëra anë është Këshilli i cili ka nevojë për një staf të kualifikuar që duhet të vijë nga radhët e gjyqtarëve, dhe nga ana tjetër gjykatat që kanë nevojë për gjyqtarë. Për shkak të emërimit të të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, ne mendojmë se ekzistojnë pritshmëri të larta të zbutjes së shkallës së dëmtimit të funksionalitetit ose cenimit të funksionalitetit të gjykatave të shkallëve të para, dhe në këtë këndvështrim, komandimi i 2 (dy) gjyqtarëve në pozicionin e nëpunësit përgjegjës është i mundshëm.

Vlerësojmë edhe një herë nismën, objektivat që ka Këshilli për të plotësuar vendet vakante në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vendet vakante në Gjykatën Administrative të Apelit si dhe vendet vakante në procedurat e lëvizjeve paralele, që janë shumë si pozicione dhe do duhet një punë jashtëzakonisht e madhe e Këshillit duke u fokusuar edhe tek njësia e vlerësimit, një punë e nëpunësve përgjegjës në njësinë e vlerësimit, për të bërë analizat përkatëse të vlerësimeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për t’u ngritur në detyrë apo për të përfituar nga procedura e lëvizjeve paralele.

Struktura e projektvendimit:

Në Kreun e Parë të këtij vendimi, si strukturë është parashikuar rishpallja e kërkesës për kandidatura, ku përcaktohet në pikën e parë rishpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 2 (dy) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në pikën e 2, lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesave parashikohet se afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është: opsioni 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi ose ta vendosim sot në vendim, të jetë data 15.11.2024. Sot është data 31 (pesëmbëdhjetë ditë, është dy javë, ditë e premte).

Në pikën e tretë të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati që do aplikojë në këtë procedurë. Këto dokumente përfshijnë kërkesën me shkrim për shfaqjen e vullnetit për kandidim në pozicionin e shpallur; jetëshkrimin, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, të dhënat mbi historikun e arsimit, rezultatet e tij; certifikatë/dëshmi për gjuhën të huaj, 5 (pesë) dokumente ligjore që mund të jenë vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës; vetëdeklarim për mosdodhjen në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor; rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup; çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Në Kreun e dytë, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit.

Në pikën e parë të këtij kreu përcaktohet se kohëzgjatja e komandimit të jetë 2 (dy) vjet, me të drejtë ripërsëritje brenda afatit 5-vjeçar.

Në pikën e dytë, përcaktohen rastet e përfundimit të komandimit para afatit, që mund të jenë: me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara; kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e larta të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit; kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore; kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen; kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra; për shkak të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat i komanduar.

Në pikën e fundit është parashikuar në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike nga funksionarët publikë”.

Në pikën 3 të Kreut të dytë, jepen kriteret e komandimit që janë: eksperiencia në punë si gjyqtar jo më pak se 3 (tre) vjet; komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; kandidati të mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; kandidati të mos jetë i komanduar; kandidati që ka qenë i komanduar më parë, i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vite si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit ii) nuk duhet të ketë kaluar

6

kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; kushti që magjistrati të mos jetë nën një masë disiplinore në fuqi; kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare të përmendura më lart.

Në pikën 4, të këtij Kreu, përcaktohen rastet kur një kandidat ka përparësi gjatë procedurës së përzgjedhjes. Si e tillë ai duhet të ketë ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve, rregulloreve; duhet të ketë njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor; duhet të jetë autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; duhet të ketë njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian; si dhe të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, personale dhe angazhimi profesional, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale. Vlerësohet edhe eksperiencia në administratë publike.

Në pikën 5, përcaktohet dokumentacioni mbi bazën e të cilit do bëhet vlerësimi, që mund të jetë dokumentacioni i paraqitur nga vetë ai, dokumentacioni i administruar nga Këshilli apo dokumentacioni që ndodhet në dosjen personale të kandidatit si dhe në çdo dokument tjetër që mund të merret nga burimet e përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 6, përcaktohet procedura që do ndiqet nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vlerësimin nëse komandimi i kandidatëve është apo jo në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin. Kjo gjë bëhet brenda dy javëve pas afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kritereve të tjera ndaluese të komandimit.

Në pikën 7 të këtij Kreu, përcaktohet procedura që do zbatohet pas vlerësimit të bërë sipas pikës gjashtë. Kështu procedura vijon me vlerësimin e kritereve të përparësisë

së kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi sipas pikës 6 të këtij Kreu (do t'i nënshtrohen kësaj procedure). Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mundet edhe të intervistojë kandidatin për verifikimin e kriterëve të kandidimit. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim.

Në pikën 8, përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale brenda dy javëve duhet të paraqesë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku pasqyrohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kriterëve të kandidimit, përfshirë edhe atyre preferenciale bashkë me renditjen e tyre, duke filluar nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrin e kandidatit të renditur më lart.

Në pikën 9, parashikohet se brenda një jave nga paraqitja e raportit dhe propozimit për komandim, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor thërret mbledhjen plenare, për të vendosur në lidhje me komandimin e gjyqtarit kandidat në pozicionet e hapura.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 10, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për gjyqtarin kandidat të propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Gjithashtu në këtë pikë përcaktohet se në rast të mosmiratimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër kandidat që plotëson kriteret e komandimit. Ky propozim i nënshtrohet sërish votimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën e fundit të projektvendimit rregullohet situata ligjore kur për asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk arrihet që të bëhet komandimi i tyre. Në këtë rast Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicioneve “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Ilir Rusi:* Faleminderit zoti Kurushi!



Ka diskutime?

Po zonja Muçi!

**Emona Muçi:** Atëherë, po shikoja relacionin dhe kjo është hera e tretë që është bërë propozimi brenda vitit në lidhje me plotësimin e vendeve vakante pranë njësisë së vlerësimit dhe me sa mbaj mend herën e parë, janë paraqitur dy kandidatura të cilat janë znj. {...} dhe {...}.

Herën e dytë në rishpalljen e periudhës në maj në mos gaboj, nuk ka ardhur asnjë kandidaturë. Në atë kohë mbaj mend që në kuadër edhe të plotësimit të këtyre vendeve vakante por edhe duke parë që nuk kemi asnjë pritshmëri ose asnjë prej magistratëve nuk kishte shprehur interesin, propozova që afati trevjeçar të zbritet dhe të bëhet 2 vjet eksperiencia e punës. Në këtë mënyrë rritet numri i atyre magistratëve të cilët kanë mundësi për të shprehur interesin por njëkohësisht edhe mund të rezultojë e suksesshme nga ana jonë, pikërisht për shkak edhe të nevojave të mëdha që duhet të plotësohet në këto momente, me qëllim plotësimin e të gjitha procedurave për ngritje në detyrë, të cilat nuk janë pak, edhe sot mund të rriten. Pikërisht për këto arsye, për këto argumente duhet të rishikohet mendoj, sikurse u tha edhe në mbledhjen e majit që afati trevjeçar mund të zbritet në një afat 2 vjet vjetërsi në punë, me qëllim, gjithë ata persona që kanë 2 vjet vjetërsi dhe nuk kanë 3 (që janë më shumë), mund të aplikojnë dhe të shfaqin interesin.

Argument tjetër mendoj që është edhe pjesa e llojit ose të përshkrimit të punës që bën pikërisht nëpunësi për vlerësimin. Domethënë ai bën një raport analitik, bën një përshkrim të përgjithshëm të dosjes. Nuk ka ndonjë... se mbaj mend që herën e kaluar u diskutua rëndësia e raportit dhe për këtë arsye ishte legjitimuar vjetërsia prej 3 vjetësh. Është relatori në vlerësime, është edhe Këshilli i cili vendos në lidhje me procedurën përfundimtare të vlerësimit. Raporti mendoj që mund të përballohet edhe nga një magistrat që ka 2 vjet vjetërsi në punë dhe jo 3.

Kështu që unë propozoj për t'u riparë vjetërsia në punë e kandidatëve të cilët mund të shprehin interesin në aplikimin për vendet vakante të cilat u rishpallën për herë të tretë brenda këtij viti.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Muçi!

Ka ndonjë diskutim?

Po, zoti Kurushi!

**Klodian Kurushi:** Atëherë, vetëm një diskutim të vogël në lidhje me këtë pjesën e propozimit që bëri kolegja. E kemi diskutuar një herë dhe për fat po vazhdojmë prapë ta diskutojmë edhe herën e dytë. Unë që herën e parë edhe sot bashkë me kolegët e komisionit kemi ndarë atë mendim të cilin e kemi pasqyruar edhe në propozimin e bërë në projektvendimin e radhës. Ne mendojmë që afati trevjeçar është afati minimal i mundshëm që duhet të plotësojë një nëpunës përgjegjës për të kryer atë detyrë në njësinë përkatëse të vlerësimit etik dhe përvojës profesionale. Është e vërtetë që ata paraqesin një raport analitik, por nuk duhet t'ia ulim vlerën raportit analitik sepse ai është përshkrimi i të gjitha fakteve që relatorit i vihet në dispozicion paraprakisht për të bërë më pas relacionin dhe propozimet për pikëzimin, dhe përcaktimin e niveleve për kandidatin që duhet të vlerësohet për punën e tij gjatë periudhave të vlerësimit.

Mos të harrojmë, vazhdoj ta përmend edhe një herë, afati trevjeçar është një afat minimal. Nëpunësit përgjegjës do vlerësojnë në këtë rast gjyqtarë të cilët kanë një përvojë të jashtëzakonshme në punën e tyre, përveçse atyre që janë të rinj, por edhe gjyqtarë që kanë përvojë të jashtëzakonshme (15 vjet, 20 vjet, 25 vjet), dhe në këtë pikë, edhe trajtimi financiar që i bëhet një nëpunësi është i barabartë me trajtimin financiar të gjyqtarit të gjykatës së apelit. Kështu që në këtë pikë ne mendojmë, nga përvoja që kemi gjetur këtu, nga Këshilli, është përcaktuar një nivel minimal përvojë që është afati 3-vjeçar. Ai që është me dy vjet, mund të diskutojmë edhe atë që është me një vit, edhe me atë që është pa vit, por e gjitha kjo nuk duhet të na çojë në humbjen e cilësisë së përgatitjes së raporteve analitike që për neve mendoj që është një akt i rëndësishëm. Është akt ligjor dhe është i rëndësishëm në këtë aspekt. Kështu që afati 3-vjeçar është një afat i menduar nga Këshilli, i arsyeshëm, ku edhe nëpunësit përgjegjës gëzojnë përvojën e mjaftueshme për të bërë një përcaktim të mirë të të gjitha rrethanave të faktit që ata do t'i hedhin në raportin e tyre analitik.

Kështu që unë mendoj që afati 3-vjeçar është afat minimal i arsyeshëm. Mbase do duhej ndoshta edhe më tepër sesa afati 3-vjeçar, por ky është i mjaftueshëm për të joshur dhe rekrutuar kandidatët për të ardhur në njësinë përkatëse.

Faleminderit!

**Emona Muçi:** Vetëm dua të them diçka, në kuadër të vijueshmërisë së debatit me kolegun.

Ka kuptim për shkak të ligjit në rast se neve flasim për një afat 5 vjet, 10 vjet. Afatet 2-3 vjeçare janë afate aty-aty, që ti mund të rrish edhe brenda 5 viteve dhe e mëson vitin e fundit, 5-vjeçarin e fundit. Për më tepër, nëpunësja përgjegjëse nuk bën vlerësimin. Domethënë me ligj, nuk e bën. Kështu që në momentin që ne do ishim përpara një afati 7-vjeçar që ka magjistrati për të konkurruar në një shkallë tjetër, pra për t'u ngritur në detyrë, ose një 5-vjeçar, por 2 me 3 nuk më duket kaq e rëndësishme ajo pjesa e përfitimit të përvojës së vlefshme me qëllim për ta pasqyruar gjatë punës së përditshme të saj.

Unë mendoj në këtë rast, mendoj për të mirën e Këshillit. Këshilli ka një punë shumë të madhe përpara. Kërkon të arrijë ca objektiva të cilat të paktën kemi gjatë gjithë vitit që neve i kemi si barrë, plotësimin e vendeve vakante në apel. Kjo barrë nuk mund të hiqet as duke folur ne, as duke u lutur. Kjo barrë hiqet vetëm duke ardhur magjistratët të cilët shprehin interesin për të qenë prezent për të na ndihmuar me raportet, të cilat më pas i kalojnë relatorit dhe i kalojnë mbledhjes plenare. Ky është qëllimi im. Nuk është qëllimi domethënë të flasim çfarë është treshi apo dyshi; sa përfiton gjatë dy viteve apo tre viteve. Domethënë gjithë analiza ime që kam bërë është e tillë, që të jem dhe transparente, personat të cilët kanë tre vite vjetërsi (që të jemi dhe korrektë dhe të jemi dhe të sinqertë me veten tonë) aplikojnë për lëvizje paralele, nuk kanë shumë dëshirë për të ardhur, sepse i plotësojnë mundësitë për të pasur një vlerësim. Kështu që këta persona nuk parapëlqejnë të vijnë në Këshill. Kjo ka qenë të paktën sa ka ndodhur gjatë këtij viti.

Dua të them vetëm një gjë. Ky ka qenë propozimi i majit i imi dhe madje thamë që në qoftë se nuk do japi rezultat, do rishihet herës tjetër. Dhe unë po i vazhdoj të njëjtës... nuk kam asnjë interes as për dyshin as për treshin.

**Ilir Rusi:** Ka diskutime të tjera?

Po! Po, zonja Plaku!

**Irena Plaku:** Atëherë është e vërtetë diskutimi që gjyqtari ka një vit, ka dy vjet apo tre vjet, çfarë ndryshon? Ndryshon në fakt, mendoj unë. Unë duke qenë se kam qenë gjyqtare, unë kam ndryshuar çdo vit pune, duke ardhur duke përmirësuar normalisht sepse fillimisht një gjyqtar i ri nuk di ku është dosja (të paktën këtë e kam unë nga eksperiencia ime personale). Sa fillimisht të mësosh dosjen, jo afatet. Është e vërtetë që nëpunëset përgjegjëse bëjnë një përshkrim, por përshkrimi i tyre nuk është thjesht si sekretaret gjyqësore që bëjnë një përshkrim të tillë çfarë panë në dosje, sepse i bie pastaj që faqet e raportit analitik do ishin pa fund, por referojnë dispozitat, bëjnë ndarjen për shembull kur bëhen të dhënat statistikore, ndarjen e afateve ligjore standarde. Prapë do thuash nuk është e nevojshme. Bëjnë përshkrimin e veprimeve të nevojshme procedurale që kryen gjyqtari. Në të vërtetë i bëjnë përshkrim, por arrijnë të identifikojnë këto veprime. Unë kam ndryshuar personalisht. Po flas nga eksperiencia ime. Nuk po marr asnjë lloj eksperience tjetër. Ndryshon, dhe çdo vit ndryshon. Gjyqtari çdo vit edhe përmirësohet. Dhe aq më tepër kur do vlerësohen edhe gjyqtarë të apelit, unë mendoj që nuk mund të zbresin poshtë 3 vjet.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka parashikuar, që për të qenë anëtar i Këshillit, duhet minimumi 10 vjet sepse ndër të tjera do vlerësojnë edhe gjyqtarët e apelit dhe kemi statusin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë, çka kërkon një lloj eksperience më të madhe. Ndryshe, po të themi që është 5 vjet gjyqtar dhe normalisht e ka mësuar eksperiencën 5 vjet... Po pra, kriteret ligjore. Kriteret ligjore janë bazuar, them unë, edhe duke pasur parasysh synimin.

*(Dikush nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)*

Patjetër, por them që nuk është kaq përshkrim sepse ashtu nuk do ishte e nevojshme, them unë, të merrnim gjyqtarë por do ishte e nevojshme të merrnim sekretarë gjyqtarë apo një nëpunës të thjeshtë.

Ligji ka parashikuar, për shkak të rëndësisë, që të jenë gjyqtarë dhe ndër të tjera, një gjyqtar, kur merr pagën e një gjyqtari të apelit, do të thotë që duhet të ketë një eksperiencë. S'po them që janë 7 vjet, por që e mira është që të ketë eksperiencë.

*(Dikush nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonin.)*

Për sa kohë që po thua 'përshkrim i thjeshtë', nuk është kaq i thjeshtë sepse duhet të jetë gjyqtar.

*(Dikush nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonin.)*

Jo, nuk është e njëjtë. Pastaj po të fillojmë diferencën, ç'u bë një e ç'u bë dy me pak fjalë?!

Unë mendoj që ne duhet ta mbajmë këtë standard.

**Ilir Rusi:** Po, zoti Hado!

**Ridvan Hado:** Po ç'ndodh nëse s'konkurron asnjë, çfarë do bëjmë?

**Irena Plaku:** Do hapim prapë.

Më fal, po ne kemi hapur apelin e Shkodrës, njëqind herë është hapur nga Këshilli dhe nuk ka pas kandidatë. Pse, ulëm standardet ne?

Po të fillojmë, se ka apo jo kandidatë nuk... Edhe pastaj arsyetimi tjetër që themi që këto kanë aplikuar për lëvizje paralele, në qoftë se gjyqtarët nuk e kuptojnë rëndësinë dhe privilegjet që përfitojnë me qenë nëpunës të Këshillit për shkak se i njihet një lloj bonusi, nuk e kuptojnë...

*(Dikush nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonin.)*

Po absolutisht që nuk do aplikojnë. Ka pasur periudha të tilla që nuk kanë aplikuar. Pra ne nuk mund të themi që do ulim kërkesat për shkak se nuk kemi.

*(Dikush nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonin.)*

Unë them që, me tre nëpunëse kemi qenë edhe më përpara edhe kemi punuar.

Jo, ne duhet të hapim dhe të bëjmë përpjekje, çdo vit do bëjmë përpjekje. Çdo vit do bëjmë përpjekje.

*(Dikush nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonin.)*

Ne në fakt patëm tre kandidatura dhe zgjodhëm të marrim dy për shkak se pamë dhe funksionalitetin e gjykatës. Patëm katër fare.

*(Dikush nga anëtarët ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)*

Dy morëm. Pse? Shikuam edhe interesin e gjykatës edhe gjithmonë ne, pavarësisht se mund të kemi shumë nevojë në Këshill, por në qoftë se është e pamundur ta marrim për shkak se cenohet funksionaliteti i një gjykate, ne përsëri nuk do ta marrim. Pse? Nuk e marrim dot. Do shikojmë kush është interesi më i mirë i mundshëm. Se në qoftë se një gjyqtar vjen këtu dhe ka lënë 800 dosje, ku u pa interesi?

***Ilir Rusi:*** Ju faleminderit!

Edhe një herë fjala për relatorin dhe pastaj kalojmë sipas procedurës.

***Klodian Kurushi:*** E fundit dhe e mbyll fare.

Është vendosur afati trevjeçar, mendoj unë, si afat i arsyeshëm, referuar një dispozite konkrete ligjore ku për çdo magjistrat gjyqtar rifillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional, pra duhet të jesh tre vjet që të fillojë edhe vlerësimi - është afat ligjor - që të fillojë vlerësimi etik dhe profesional për atë vetë. Të paktën duhet të përmbushi këtë lloj kriteri që më pas të jesh edhe subjekt i vlerësimit nga Komisionit. Ky është afat referues, por është afat ligjor.

***Ilir Rusi:*** Atëherë, jemi në një situatë që relatori i qëndron propozimit përkatës që ka bërë. Ndërkohë që kemi propozim nga një anëtare, zonja Muçi, që thotë, kandidati të ketë të paktën 2 vjet përvojë profesionale.

Hedhim në votim propozimin e zonjës Muçi.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Irena Plaku:*** Kundër.

***Gentiana Muçaj:*** Kundër.

***Ridvan Hado:*** Kundër.

***Bledar Bajri:*** Kundër.

**Albens Tabaku:** Kundër, edhe mund të argumentoj një opinion të shkurtër fare. Në qoftë se këtu ulim standardin profesional, ndërkohë në përzgjedhje nëse kemi, referohet për të përzgjedhur, kandidati duhet të plotësojë pastaj ekspertizat në fushën e hartimit të akteve rregullatore, të ketë përvojë në administratë publike, në legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian, është autor i artikujve ose botimeve shkencore. Pra, ndërkohë që ne ulim kriterin profesional, ndërkohë kërkojmë edhe kriter akademik, gjë që më duket mua, ndoshta me modesti po e them, në kundërshtim. Ndoshta duhet të gjejmë mënyra të tjera për të tërhequr/për të sjellë. Por unë jam kundër në këtë aspekt.

**Markelian Koça:** Kundër.

**Violanda Theodhori:** Kundër.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i zonjës Muçi.)

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë në votimin e projektvendimit me përditësimin e afatit kohor që duhet të jetë data 15.11.2024 si afat i paraqitjes së kërkesave për komandim. 15.11.2024, ditë e premte.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për rishpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit, me një përditësim që afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 15.11.2024, ditë e premte.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

- 2.1 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.2 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.3 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.4 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.5 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.6 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.7 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.8 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.9 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

17

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 31.10.2024 (Pika 2)***

- 2.10 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.11 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.12 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.13 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.14 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.15 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.16 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.17 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.18 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 2.19 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 2.20 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

*Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

*1. Ilir Rusi*

*(kryetar)*

18

- |                               |                           |
|-------------------------------|---------------------------|
| 2. <i>Yllka Rupa</i>          | <i>(zëvendëskryetare)</i> |
| 3. <i>Klodian Kurushi</i>     | <i>(anëtar)</i>           |
| 4. <i>Irena Plaku</i>         | <i>(anëtare)</i>          |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i>      | <i>(anëtare)</i>          |
| 6. <i>Ridvan Hado</i>         | <i>(anëtar)</i>           |
| 7. <i>Bledar Bajri</i>        | <i>(anëtar)</i>           |
| 8. <i>Albens Tabaku</i>       | <i>(anëtar)</i>           |
| 9. <i>Markelian Koça</i>      | <i>(anëtar)</i>           |
| 10. <i>Violanda Theodhori</i> | <i>(anëtar)</i>           |
| 11. <i>Emona Muçi</i>         | <i>(anëtare)</i>          |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Artan Rama.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

2.1 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

- 2.2 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.3 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.4 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.5 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.6 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.7 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.8 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.9 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.10 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.11 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.12 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.13 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.14 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.15 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 2.16 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.17 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

2.18 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

2.19 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

2.20 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

***Ilir Rusi:*** Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator është z. Kurushi, në lidhje me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicione civile dhe penale. Fjala për ju zoti Kurushi!

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit z. Kryetar!

Po parashtrojmë relacionin e radhës. Paraprakisht në relacion ne kemi bërë propozimet tona që janë njohur të gjithë anëtarët e Këshillit por për shkak të ndryshimit të disa rrethanave nga momenti që ne kemi çuar relacionin, që ka qenë muaji korrik i këtij viti, deri tani në muajin tetor, kemi marrë në analizë edhe disa rrethana të tjera të cilat na detyrojnë të bëjmë edhe një propozim tjetër alternativ përveç asaj çfarë ne kemi propozuar në relacionin me shkrim të dërguar për të gjithë anëtarët.

Projektvendimi lidhet me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës penale.

Sipas vendimit të Këshillit, nr. 505, datë 21.11.2022, struktura organizative e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është me 78 gjyqtarë.

Aktualisht në Gjykatën Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm referuar organikës së përditësuar të datës 30.09.2024, kjo organikë rezulton si më poshtë:

- Struktura Organizative është me 78 gjyqtarë;

- Organika në fakt aktualisht është shënuar 33, por është bërë 34 sepse kemi ngritur në detyrë edhe zonjën {...} gjatë kësaj kohe.

- Efektivisht në detyrë, është shënuar 27, por janë 28 gjyqtarë.

Bashkëlidhur është edhe numri i strukturës organizative, numri i gjyqtarëve sipas organikës në fakt, numri i gjyqtarëve efektiv në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe numri i pozicioneve të lira që janë në proces verifikimi dhe në proces ngritjeje në detyrë, si dhe numri i vendeve të tjera vakancë të lirë një pjesë e të cilave ne propozojmë sot hapjen e tyre për të shpallur pozicione të lira dhe për të marrë shprehjen e interesit dhe të kërkesave nga ana e kandidatëve.

Situata e procedurave të hapura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga krijimi i tij deri më sot ka përfunduar me sukses procesin e ngritjes në detyrë gjithsej janë 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Tashmë kemi përfunduar edhe të shtatëmbëdhjetin që është zonja {...}, e kemi ngritur në detyrë në këtë periudhë kohe (pra së fundmi).

Në proces janë gjithsej janë 12 pozicione të lira. Pozicionet e hershme janë ato që i përkasin nr. 502, 503, 504 të fushës penale të shpallura në nëntor 2022. Për pozicionin 502 dhe 503 vijon procedura e vlerësimit të kandidatëve; njëkohësisht për pozicionin 503, 504 vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve si edhe për një kandidat vijon procesi i kualifikimit në Këshill.

Pozicionet 239-247 i përkasin fushës civile dhe janë shpallur me vendim në maj 2023; për dy pozicione: nr. 243, ka përfunduar procedura, si dhe për pozicionin nr. 242 është përfunduar procedura.

Pozicionet nr.244-246 i përkasin fushës së të drejtës civile dhe janë shpallur në maj të vitit 2024; Për këto pozicione procedura e verifikimit kanë filluar në qershor 2024 dhe kandidatët kanë kaluar fazën e verifikimit të kriterëve formale.

Nisur nga sa më sipër, mund të mendohet se në një kohë jo shumë të largët, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm plotësohet edhe me 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë të tjerë, duke arritur numrin e gjyqtarëve të saj në detyrë në total diku 40 (dyzet), 41 (dyzet e një) (pak më shume se 50% e numrit të përgjithshëm të Gjykatës së Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm).

Siç u parashtrua edhe më lart, aktualisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka gjithsej diku tek 44 (dyzet e katër) pozicione të lira të përhershme, ku për plotësimin e 13 (trembëdhjetë) prej tyre janë në proces procedurat përkatëse të ngritjes në detyrë nga Komisionet e Vlerësimit Etik dhe të Përvojës Profesionale si dhe procedurat e tjera janë në verifikimin e kriterëve ligjore nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mekanizimi i transferimit të gjyqtarëve nëpërmjet lëvizjes paralele, i parashikuar në germën “ç” të paragrafit 2 neni 43 të Ligjit për Statusin, nuk është i mundur të aplikohet, pasi nuk ka gjyqtarë të cilët të plotësojnë kriteret sipas parashikimit ligjor të sipërcituar. Kemi vetëm një Gjykatë Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe bëhet i pamundur zbatimi i mekanizmit të procedurës së lëvizjeve paralele.

Ngarkesa aktuale - Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në relacion është përfshirë ngarkesa aktuale e secilit gjyqtar në Gjykatën e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në informacionin e përcjellë me postë elektronike më datë 30.09.2024 (kur është bërë ky relacion) nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm rezulton se: “Pranë Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë në total 27 (tani janë bërë 28) gjyqtarë nga të cilët (seksionet janë të ndara pothuajse në mënyrë të barabartë): 14 me 14.

Në total janë gjithsej 40.000 dosje të regjistruara dhe të pagykuara, nga të cilat 14.000 janë çështje të natyrës penale, dhe 26.000 janë çështje të natyrës civile.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ka mbajtur në vëmendje: i) situatën aktuale dhe atë të pritshme në plotësimin e vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; ii) numrin e lartë të çështjeve që ka kjo gjykatë; iii) stokun e çështjeve; iv) kohëzgjatjen e procedurave të ngritjes në detyrë, vlerëson se fillimi aktualisht i 20 (njëzet) procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile/penale, do të mundësonte plotësimin e pozicioneve të lira në një kohë më të shpejtë, duke rritur në këtë mënyrë funksionalitetin e kësaj gjykate, ndërkohë që stoku i çështjeve për gjykim përpara kësaj gjykate deri më datë 30.06.2024 është 39.808 çështje, pra afërsisht 40.000 çështje. Kjo dëmton të drejtën

e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm (duke mbajtur në vëmendje edhe praktikatat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

Konsiderata mbi projektvendimet:

Mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”, pika 1 dhe pika 4, e nenit 47, në pikën 2, shkronjat “a”, “b”, “c” të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar 20 projektvendime të reja për hapjen e procedurës të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushat e së drejtës civile dhe penale, referuar të njëjtit kriter të konsideruar edhe më parë nga Këshilli, pra numrit të çështjeve sipas llojit në lëndën e tyre, si dhe nevojës së gjykatës për gjyqtarë të profilizuar.

Në 20 projektvendimet e propozuara, fillimisht në relacion ne kemi propozuar që 17 (shtatëmbëdhjetë) prej pozicioneve t’i përkasin fushës civile, dhe 3 (tre) të mbetura t’i përkasin fushës së të drejtës penale. Komisioni në këtë rast i është referuar ngarkesës së gjykatës si edhe mban në vëmendje faktin se 10 nga 13 pozicionet aktuale të hapura i përkasin fushës civile.

Projektvendimi në këtë rast titullohet “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile/penale”.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimit në fushën e së drejtës civile/penale, ai është strukturuar në 4 Krerë, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 5, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016.

Alternativisht, siç e parashtrova edhe më lart, duke iu referuar rrethanave të reja të cilat ne do t’i parashtrojmë paraprkisht përpara Këshillit, unë si relator po bëj edhe një propozim tjetër alternativ, përveçse asaj çfarë është propozuar në relacion, po bëj edhe një propozim alternativ që i përket jo numrit të përgjithshëm të vendeve që ne do

24



hapim, pasi ai do jetë 20 dhe i pandryshueshëm, por raportit ndërmjet vendeve të lira në fushën e së drejtës civile me ato në penale dhe këtë propozim të ri e bëj duke iu referuar disa rrethanave të cilat unë po i parashtroj.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar hapjen e 20 vendeve vakant mbajtur në vëmendje:

-Situatën aktuale dhe atë të pritshme në këtë gjykatë;

-Numrin e lartë të çështjeve që ka kjo gjykatë në gjykim;

-Stokun e dosjeve që janë afërsisht rreth 40.000;

-Kohëzgjatjen e procedurave të ngritjes në detyrë; dhe Komisioni propozoi fillimisht që nga 20 vende të lira, 17 (shtatëmbëdhjetë) prej tyre t'i dedikohen fushës civile dhe 3 (tre) fushës penale.

Komisioni iu referua ngarkesës së gjykatës si dhe mbante në vëmendje faktin se 10 nga 13 pozicionet aktuale të hapura i përkasin fushës civile.

Në mënyrë alternative Komisionit duke mbajtur në vëmendje që: i) pozicionet penale të hapura më herët në kohë ende nuk janë përfunduar dhe kërkojnë ende kohë në procesin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (janë pozicione të nëntorit të vitit 2022). Ne kemi pritshmërinë që ato besojmë se mund të përfundojnë në fund të këtij viti. ii) Nga pozicionet civile, ndonëse të shpallura në maj të 2023 dhe fillimi i verifikimit të tyre u bë në shkurt të 2024, janë ngritur aktualisht në detyrë dy gjyqtarë dhe shumë shpejt pritet të përfundojnë edhe dy të tilla, pra po ecën më shpejt procedura e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve kandidatë në procedurat që lidhen me pozicionet civile të hapura në vitin 2023 dhe 2024; iii) evadimin e çështjeve civile dhe penale gjatë vitit 2023 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, kanë qenë në shifra pothuajse të barabarta, ku nga ana tjetër çështjet penale me afate më të ngutshme, më të shpejta për t'u përfunduar për shkak se prekin edhe liritë individuale të lëvizjes së personave që ndodhen nën masa sigurimi shtrënguese “arrest shtëpie”, “arrest në burg”, ose masa të tjera;

Duke i marrë në konsideratë këto rrethana, propozojmë duke inkurajuar edhe një herë kandidatët që t'u jepet mundësia për të kandiduar në një raport më proporcional midis fushave të së drejtës civile dhe fushave të së drejtës penale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në këtë pikë unë bëj një propozim alternativ, nga 20

25

pozicione të shpallura, mendoj si alternativë: 12 prej tyre t'i përkasin fushës civile dhe 8 prej tyre t'i përkasin fushës së të drejtës penale, pra të ketë një grup më të balancuar dhe më proporcional midis propozimeve që ne bëjmë për hapjen e 20 vendeve të reja në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Domethënë ky është propozimi i dytë alternativ për të balancuar ato efekte negative që kanë ndodhur në praktikë për shkak të gjykimit të çështjeve me natyrë penale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe ritmit, po themi, që duhet të jetë edhe më lart në gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Keni diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, të nderuar kolegë, alternativa e parë është ashtu siç ju kanë ardhur projekt-aktet, 17 civile dhe 3 penale.

Alternativa e dytë e sapo prezantuar nga relatori z. Kurushi, janë 12 civile dhe 8 penale.

Ndërkohë, në lidhje dhe me afatin e kandidimit?

**Klodian Kurushi:** Në lidhje me afatin ne propozojmë datën 15.11.2024, pra afat fiks, dy javë kohë brenda afatit ligjor, për t'i dhënë mundësi të gjithë kandidatëve të paraqesin kërkesat e tyre për shprehej interesi. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, kalojmë në votimin e alternativës së dytë të propozuar nga zoti Kurushi që është 12 vende në civile dhe 8 për penale.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

*Albens Tabaku*: Pro.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Violanda Theodhori*: Dakord.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Edhe Klodiani dakord.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Kështu që nuk ka vend për të kaluar në një votim tjetër.

Vendim “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile” – 12 vende.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Afati i kandidimit është deri më datë 15.11.2024, ditë e premte.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Ilir Rusi*: Gjithashtu, për shkak të votimit në mënyrë kumulative, vendim “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale” – 8 pozicione.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

Afati i kandidimit është deri më datë 15.11.2024, ditë e premte.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduara nga relatori z. Ilir Rusi”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                           |
|---------------------------|---------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(kryetar)</b>          |
| <b>2. Yllka Rupa</b>      | <b>(zëvendëskryetare)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>           |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>          |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>           |
| <b>7. Bledar Bajri</b>    | <b>(anëtar)</b>           |
| <b>8. Albens Tabaku</b>   | <b>(anëtar)</b>           |

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

*Shënime:* Nuk morën pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça* dhe znj. *Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Artan Rama.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduara nga relatori z. Ilir Rusi”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

*Ilir Rusi:* Atëherë, për arsye objektive, do kalojmë tek pika e gjashtë e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduara nga relatori z. Ilir Rusi”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Relatore do të jetë zonja Plaku.

Gjithashtu, bëj me dije faktin që z. Koça dhe znj. Muçi nuk do të jenë në shqyrtimin dhe diskutimin e kësaj pike të këtij rendi dite për shkak të konfliktit të interesit.

Zonja Plaku, vazhdoni!

***Irena Plaku:*** Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 171, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka filluar me prioritet procesin e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi për 132 gjyqtarë, për 92 nga të cilët kanë përfunduar me raporte, për 8 gjyqtarë projektraportet e të cilëve janë dërguar për mbledhje plenare, për 3 gjyqtarë është vendosur nga KVEVP-ja pezullimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për shkak të zgjedhjes së tyre si anëtarë KLGJ-je, për 6 gjyqtarë është vendosur përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar, ndërkohë që vazhdojnë procedurat për vlerësimin e 23 gjyqtarëve të tjerë, 6 prej të cilëve kanë në cilësinë e relatorit, zotin Rusi.

Veç procedurave të vlerësimit të gradimit, në zbatim të neneve 85 dhe 97 të ligjit dhe vendimit nr.263/2019, ka filluar procedura e përshpejtuar e vlerësimit etik dhe profesional për disa gjyqtarë për shkak të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë apo lëvizjes paralele.

Gjithashtu në zbatim të programit të vlerësimit të miratuara për vitet 2021, 2023 dhe 2024, Këshilli ka filluar procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për periudhat 3-vjeçare të vlerësimit (2017-2019; 2020-2022 dhe 2021-2023) për 82 gjyqtarë, ku për 29 gjyqtarë vlerësimet janë miratuar nga Këshilli, për 5 gjyqtarë projektraportet janë dërguar për shqyrtim mbledhjes plenare, ndërkohë nga këto procedura 14 janë në cilësinë e relatorit, të anëtarit z. Ilir Rusi.

Me vendimin nr. 626, datë 22.10.2024, z.Rusi është zgjedhur Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në mbështetje të nenit 62 dhe 63 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Këshilli ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit nr.13, datë 18.01.2019 “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar,

30

duke ndryshuar tashmë përbërjen e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me anëtarët znj. Irena Plaku, znj. Gentiana Muçaj dhe znj. Violanda Theodhori.

Ndodhur në këto kushte, kur ka ndryshuar edhe përbërja e anëtarëve të Komisionit dhe pasur parasysh se 24 procedura vlerësimi i përkasin/kanë qenë të anëtarit z. Ilir Rusi, në kushtet kur ky i fundit është zgjedhur Kryetar, ka lindur nevoja për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit për 24 procedura vlerësimi (periudha e gradimit, periudha e vlerësimit trevjeçare dhe 2 vlerësime të vlerësimit të përshpejtuar).

Ndodhur në këto kushte, nga Komisioni është vlerësuar përfshirja e tre anëtarëve në short duke pasur parasysh për aq sa është e mundur barazinë e shpërndarjes së punës, prioritet e Këshillit që duhet të përfundojnë sa më shpejt procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve që janë në procedurën e ngritjes në detyrë, është vlerësuar që për anëtarën znj. Violanda Theodhori të shortohen 12 procedura vlerësimi, për anëtarët Irena Plaku dhe Gentiana Muçaj nga 6 procedura për secilën.

Është përcaktuar në relacion edhe mënyra se si do shortohen, ku do jenë shiritat e gjyqtarëve për vlerësim dhe shiritat e anëtarëve të Komisionit.

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në 6 procedurat e vlerësimit për periudhën e gradimit.

Në pikën e dytë të projektvendimit përcaktohet relatori në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën trevjeçare të vlerësimit, ku janë përcaktuar edhe emrat e gjyqtarëve dhe periudhat e vlerësimit.

Në pikën e tretë përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit të përshpejtuar për dy gjyqtarë, të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë.

Si dhe në pikën e katërt përcaktohet fillimi i procedurës për një periudhë 5-vjeçare për gjyqtaren {...}.

Në pikën e pestë përcaktohet fillimi i relatorit për gjyqtaren {...} e cila ka qenë e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Ilir Rusi*: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime mbi çfarë u prezantua dhe mbi mekanizmin e hedhjes së shortit?  
(Nuk ka diskutime.)

Atëherë ftoj administratën të përgatisë dhe të hedhë shortin sipas mekanizmit të prezantuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë goglat me shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë goglat me shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Violanda Theodhori (12 shirita me emrin e saj); znj. Irena Plaku (6 shirita me emrin e saj) dhe znj. Gentiana Muçaj (6 shirita me emrin e saj).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Kandidati i parë i përzgjedhur është numri 4, znj. {...} (2017-2021). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Kandidati i dytë i përzgjedhur është numri 2.4 znj. {...} (2017-2019). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i tretë i përzgjedhur është numri 1.2, znj. {...} (gradimi). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

Kandidati i katërt i përzgjedhur është numri 2.14, znj. {...} (2021-2023). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i pestë i përzgjedhur është numri 2.2, z. {...} (2017-2019). Relator për zotin {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Kandidati i gjashtë i përzgjedhur është numri 1.1, z. {...} (gradimi). Relator për zotin {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Kandidati i shtatë i përzgjedhur është numri 2.10, z. {...} (2020-2022). Relator për zotin {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.



Kandidati i tetë i përzgjedhur është numri 2.13, znj. {...} (2021-2023). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i nëntë i përzgjedhur është numri 2.3, znj. {...} (2017-2019). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

Kandidati i dhjetë i përzgjedhur është numri 1.6, znj. {...} (gradimi). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i njëmbëdhjetë i përzgjedhur është numri 1.4, znj. {...} (gradimi). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Kandidati i dymbëdhjetë i përzgjedhur është numri 2.5, z. {...} (2017-2019). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i trembëdhjetë i përzgjedhur është numri 5, znj. {...} (02.03.2020-14.06.2023). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i katërbëdhjetë i përzgjedhur është numri 3.2, z. {...} (2021). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Kandidati i pesëmbëdhjetë i përzgjedhur është numri 2.6, z. {...} (2020-2022). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i gjashtëmbëdhjetë i përzgjedhur është numri 1.3, znj. {...} (gradimi). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i shtatëmbëdhjetë i përzgjedhur është numri 2.8, znj. {...} (2020-2022). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i tetëmbëdhjetë i përzgjedhur është numri 1.5, znj. {...} (gradimi). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

Kandidati i nëntëmbëdhjetë i përzgjedhur është numri 2.9, znj. {...} (2020-2022). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

Kandidati i njëzet i përzgjedhur është numri 2.11, z. {...} (2021-2023). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

Kandidati i njëzet e një i përzgjedhur është numri 3.1, z. {...} (2022). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

Kandidati i njëzet e dy i përzgjedhur është numri 2.12, z. {...} (2021-2023). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Kandidati i njëzet e tre i përzgjedhur është numri 2.1, z. {...} (2017-2019). Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

Kandidati i njëzet e katërt i përzgjedhur është numri 2.7, znj. {...} (2020-2022). Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Violanda Theodhori.

**Ilir Rusi:** Keni diskutime në lidhje me projekt-aktin e përditësuar me rezultatet që rezultuan nga shorti i sapo hedhur?

Nuk keni diskutime.

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduara nga relatori z. Ilir Rusi”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi sipas relacionit.

1. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara nga z. Ilir Rusi, si më poshtë:

1.1 Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku;

1.2 Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj;

1.3 Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Violanda Theodhori;

1.4 Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Irena Plaku;

1.5 Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj;

1.6 Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Violanda Theodhori.

2. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, 2020-2022 dhe 2021-2023, të papërfunduara nga z.Illir Rusi, si më poshtë:

2.1 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2017-2019;

2.2 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Irena Plaku – për vitin 2017-2019;

2.3 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Gentiana Muçaj – për vitin 2017-2019;

2.4 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2017-2019;

2.5 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2017-2019;

2.6 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2020-2022;

2.7 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2020-2022;

2.8 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2020-2022;

2.9 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Gentiana Muçaj – për vitin 2020-2022;

2.10 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2020-2022;

2.11 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Gentiana Muçaj – për vitin 2021-2023;

2.12 Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Irena Plaku – për vitin 2021-2023;

2.13 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2021-2023;

2.14 Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Violanda Theodhori – për vitin 2021-2023.

3. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2021 dhe 2022, të papërfunduara nga z.Illir Rusi, si më poshtë:

3.1 Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Gentiana Muçaj – viti 2022;

3.2 Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – viti 2021.

4. Caktimin e relatorit në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2021, për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku.

5. Caktimin e relatorit në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për periudhën e vlerësimit 02.03.2020-14.06.2023, për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Violanda Theodhori.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).<sup>2</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                           |
|---------------------------|---------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i>       | <i>(kryetar)</i>          |
| 2. <i>Yllka Rupa</i>      | <i>(zëvendëskryetare)</i> |
| 3. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i>           |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i>  | <i>(anëtare)</i>          |
| 5. <i>Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>           |
| 6. <i>Bledar Bajri</i>    | <i>(anëtar)</i>           |
| 7. <i>Albens Tabaku</i>   | <i>(anëtar)</i>           |

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 3-ta sipas rendit të ditës.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Violanda Theodhori* (anëtar)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

*Shënime:* Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje *znj. Irena Plaku*. Zonja Plaku u largua dhe nuk mori pjesë më në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Artan Rama.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e

38

libre në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

**Markelian Koça:** Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë, ju paraqesim në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës projektvendimin i cili u lexua nga Kryetari. S’po zgjatem.

Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se:

Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 74, nr. 82 dhe nr. 83, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për një pozicion të libre në fushën e të drejtës civile. Afati i kandidimit ka qenë data 01.03.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e libre nr. 83, 20.02.2024 kandidoi edhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht e transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 74/2024, 82/2024 dhe 83/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur ndër të tjera: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, e vijues të datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. Caktimin e relatorit për secilin kandidat. Për kandidaten znj. {...} është caktuar z. {...}.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me vendimin nr. 189, datë 09.04.2024, ka vendosur:

1.Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 74, nr. 82 dhe nr. 83, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, me vendim nr.205, datë 17.04.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse që citohet në relacion, ka vendosur fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73 deri 86, 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.75, 20.02.2024, nr.73, 20.02.2024, nr. 83, 20.02.2024, nr. 249, 24.05.2023, nr. 81, 20.02.2024 jam caktuar unë si relator i çështjes.

Në vijim, më datë 17.04.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të përcaktimeve ligjore të cituara në relacion, kandidati është njoftuar për vendimin nr. 205, datë 17.04.2024 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidati nuk ka paraqitur kundërshtime apo kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Në vijim, në datën 11.10.2024 znj. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 83, 20.02.2024, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke parashtruar se (po lexoj vetëm pjesën e tekstit të dorëheqjes): Unë gjyqtare {...}, paraqes këtë kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi për lëvizje paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin

40



nr.83 në fushën e të drejtës civile, të shpallur përkatësisht me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”.

Bashkëlidhur materialit gjendet edhe shkresa e protokollimit dhe vetë kërkesa për heqjen dorë.

Në këto kushte vlerësohet se jemi në situatën e përcaktuar: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit”.

Është përcjellë materiali Komisionit dhe ky Komision ka vlerësuar që verifikimet janë të plota dhe e ka konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur nga zonja {...} dhe vendos t’ia kalojë Këshillit vendimmarrjen në lidhje me përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.

Projektvendimi është i konceptuar në dy pika. Në pikën e parë përcaktohet përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

Pika e dytë, një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet dhe të sigurohet për anonimitetin e subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Ilir Rusi*: Faleminderit z. Koça.

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Në vijim të kësaj mbledhjeje znj. Plaku nuk do të jetë prezent për arsye objektive. Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                           |
|---------------------------|---------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(kryetar)</b>          |
| <b>2. Yllka Rupa</b>      | <b>(zëvendëskryetare)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>           |
| <b>4. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>           |
| <b>6. Bledar Bajri</b>    | <b>(anëtar)</b>           |

<sup>3</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Violanda Theodhori* (anëtar)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

*Shënime:* Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje *znj. Irena Plaku*. Zonja Plaku u largua nga pika e katërt dhe nuk mori pjesë më në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Artan Rama.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me një pikë tjetër të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zoti Kryetar!

Në mbledhjen plenare të datës 20.02.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës. Një ndër këto pozicione ishte ai i shpallur me vendimin nr. 83, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në fushën e të drejtës civile, i shpallur me vendimin e datës 20.02.2024

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.03.2024.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për këtë pozicion, lista e kandidatëve që kishin kandidime të vlefshme në këtë pozicion ishte: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}.

Me shpalljen e kësaj liste, Këshilli, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, miratoi listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës.

Duke qenë se në këtë pozicion kishte gjyqtarë me 2 vlerësime (pra i referohem pozicionit nr. 83), Këshilli fillimisht filloi procedurën e verifikimit të kandidatëve: znj. {...} dhe z. {...}, pasi ishin kandidatë që kishin dy vlerësime dhe mund t’i bëhen dy vlerësime.

Gjatë procedurës së përzgjedhjes në këtë pozicion, si z. {...} edhe znj. {...} u tërhoqën nga ky pozicion.

Këshilli me vendimin nr. 598, datë 09.10.2024 vendosi: Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.

Këshilli me vendimin e sotëm të datës 31.10.2024 vendosi: Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi (relacioni i të cilës u parashtrua në Këshill nga z. Markelian Koça).

Gjithashtu, gjatë fazës së verifikimeve për këtë pozicion u paraqitën edhe kërkesa të aplikantëve të tjerë për heqje dorë nga ky pozicion (kandidatë më 1 vlerësim ose pa vlerësim, për të cilët sigurisht nuk kishte filluar paraprakisht më përpara procedura e verifikimit). Konkretisht kanë paraqitur kërkesë për heqje dorë:

- znj. {...} – Hoqi dorë me kërkesën e datës 14.05.2024;
- znj. {...} – Hoqi dorë me kërkesën e datës 16.05.2024;
- znj. {...} - Hoqi dorë me kërkesën e datës 17.09.2024;
- z. {...} - Hoqi dorë me kërkesën e datës 16.05.2024;
- z. {...} - Hoqi dorë me kërkesën e datës 16.05.2024.

Nuk është vijuar procedura për përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar për këta kandidatë sepse heqja dorë e tyre ishte bërë në kohën kur në atë pozicion kishte kandidatë me dy vlerësime. Kështu që procedura e verifikimit kishte nisur për kandidatët me dy vlerësime. Kështu që u arkivuan heqjet dorë të këtyre kandidatëve që nuk ishin futur në proces kandidimi dhe verifikimi për kriteret formale.

Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit [...]”.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020.

Në Kreun IV të vendimit respektiv nr. 83/2024, Këshilli ka përcaktuar procedurat përkatëse që do të ndiqen si më poshtë.

Procedurat janë të përcaktuara në atë vendim. S'po i listoj sepse i kemi thënë edhe një herë.

Në kushtet kur kandidatët me dy vlerësime për të cilët kishte filluar procedura e verifikimit u tërhoqën nga gara, së fundmi është tërhequr nga gara zonja {...} vendim i cili u miratua në këtë seancë, gjithashtu dhe ku nuk ka kandidatë të kategorisë me një vlerësim, pasi kandidatët që mund të kishin një vlerësim, siç e përmenda më lart u tërhoqën, Këshilli vijon procedurën me kandidatët që nuk kanë ose nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Sipas Shtojcës III, të vendimit nr.127, datë 11.03.2024 kjo listë është:

Shtojca III - Lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim:

Janë gjyqtarët znj.{...}, z. {...}, znj.{...}, znj. {...}, znj.{...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në shtojcën III, rezulton se 6 (gjashtë) prej tyre kanë kandiduar në pozicionin nr. 83.

Pra lista ishte për të gjithë kandidatët që nuk kishin asnjë vlerësim të cilët kishin shprehur interesin për të kandiduar në pozicionet e hapura si në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ashtu edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për pozicionin nr. 83 kandidatët pa vlerësim janë këto që unë do t'i përmend më poshtë: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Nga këta gjyqtarë të cilët aplikuan në pozicionin nr.83, u tërhoqën gjithashtu nga gara: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Në përputhje me parashikimet e pikës 11 të vendimit, nr. 83/2024, vendimin nr. 320/2020, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.



Kandidatë në këtë pozicion mbeten: z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë parashikohet: Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 83/2024, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në pikën e dytë – bëhet fjalë për caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 3 kandidatët të cilët sipas shtojcës III të vendimit nr.127/2024, janë kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Lidhur me procedurën e shortit do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme.

Në një enë hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe në enën tjetër emrat e tre kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurën e lëvizjes paralele.

Më pas shorti do të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazon tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit caktohet relator për një kandidat. Pra tre anëtarët e Komisionit të caktohen si relator për një kandidat secili.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime, dhe mbi mekanizmin e hedhjes së shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Ftoj administratën të përgatisë hedhjen e shortit sipas mekanizmit të prezantuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë goglat me shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë goglat me shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit: z. Klodian Kurushi, z. Markelian Koça dhe z. Albens Tabaku.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i kandidatit të parë – znj. {...}.

Relator për zonjën {...} përzgjidhet z. Klodian Kurushi.

Përzgjidhet emri i kandidatit të dytë – znj. {...}.

Relator për zonjën {...} përzgjidhet z. Albens Tabaku.

Përzgjidhet emri i kandidatit të mbetur në enën e qelqit – z. {...}.

Relator për zotën {...} përzgjidhet z. Markelian Koça.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit të përditësuar me të dhënat që rezultuan nga shorti i sapo hedhur.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Bledar Bajri:*** Dakord.

***Albens Tabaku:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Violanda Theodhori:*** Dakord.

***Emona Muçi:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

50

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Albens Tabaku;
2. Për kandidatin z. {...} – relator z. Markelian Koça;
3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator i procedurës ka qenë z. {...}. Në mbledhje relatohet nga z. Klodian Kurushi).<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (kryetar)
- 2. Yllka Rupa*** (zëvendëskryetare)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Bledar Bajri*** (anëtar)
- 7. Albens Tabaku*** (anëtar)

<sup>4</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Violanda Theodhori* (anëtar)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

**Shënime:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje *znj. Irena Plaku*. Zonja Plaku u largua nga pika e katërt dhe nuk mori pjesë më në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
8. *Artan Rama.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator i procedurës ka qenë z. {...}). Në mbledhje relatohet nga z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit

53

të Karrierës. Relator ka qenë ish-anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më tej fjalën e ka kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Kurushi për ta relatuar aktin.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zoti Kryetar!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 07.06.2024, është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, z. {...}, kërkesë me nr. {...} prot., me objekt “Qëndrimi në detyrë deri në moshën 70 vjeç”, referuar nenit 64, pika 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Si shkak të paraqitjes së kërkesës, magjistrati ka parashtruar se më datë 19.12.2024 ai mbush moshën 67 vjeç, moshë për të cilën ai del në pension pleqërie.

Sipas informacion te përcjell nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor rezulton se: z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datën 25.05.1980. Me vendim nr. {...}, datë 12.11.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Me dekretin nr. {...}, datë 06.03.2000 të Presidentit të Republikës emërohet Zëvendëskryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 18.02.2008 dhe në vijim ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me vendimin nr. 130, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” nga data 01.05.2023 ai ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 30 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në rastin konkret, kërkesa e z. {...} është bazuar në pikën 5, të nenit 64 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili rregullon kohëzgjatjen në detyrë e magjistratit si edhe procedurën duke përcaktuar ndër të tjera se “5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose

moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”

Si motiv të qëndrimit në detyrë z. {...} ka parashtruar ndër të tjera: [...] Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli e deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para përfundimit. Në zbatim të këtij parashikimi ligjor, duke respektuar afatin 6-mujor që parashikon kjo dispozitë, i drejtohem Këshillit të Lartë Gjyqësor që të më lejojë të vazhdoj të qëndroj në detyrën e gjyqtarit (magjistratit) deri në moshën 70 vjeç. Nuk kam masa disiplinore në fuqi, ndërsa, nga ana tjetër jam gjyqtar me rendiment të lartë në punë, referuar kjo statistikave të viteve të fundit.

E drejta për pensionin e gjyqtarit është një e drejtë që përfshihet në grupin e të drejtave ekonomiko-sociale që për nga natyra janë të drejta pozitive si edhe garantohet nga statusi që ata gëzojnë. Prandaj përmbajtja e tyre interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t’u bërë aktive për t’u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar është një e drejtë që u njihet nga ligji edhe kategorisë së gjyqtarëve për të kërkuar zgjatjen e moshës së pensionit.

Në vlerësim të akteve të administruara magjistrati z. {...} ka ushtruar këtë të drejtë kushtetuese duke paraqitur kërkesën për dalje në pension ditën që do të mbushi moshën 70 vjeç. Pra ai kërkon ta gëzojë statusin e magjistratit deri në mbushjen e kësaj moshe.

Neni 64 i ligjit të sipërcituar, ka parashikuar se për qëndrimin në detyrë paraqitet një kërkesë jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension, referuar datëlindjes 19.12.1957, (19.12.2024 është datë në cilën ai mbush moshën 67 vjeç). Kjo është e përcjellë nga gjyqtari brenda afateve të paraqitjes së kërkesës, pra brenda afatit 6-mujor. Ai e ka sjellë në muajin qershor kërkesën, para afatit 6-mujor që do të përfundonte në datë 19.12.2024.

Më tej pranimi i kërkesës përkon jo vetëm me të drejtën e magjistratit por edhe me nevojat aktuale të sistemit gjyqësor i cili për shkak të aplikimit të ligjit 84/2016, ka

pësuar hapje pozicionesh të lira të përhershme dhe të përkohshme. Ndërkohë që organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, paraqitet si vijon:

Struktura Organizative: 23 gjyqtarë;

Organika në fakt: 13 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 11 gjyqtarë.

(Relacioni është bërë në muajin qershor, pra pas muajit qershor kur është paraqitur kërkesa nga z. {...}.)

Kjo strukturë ka ndryshuar me lëvizjet e fundit që ne kemi bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku kemi dërguar gjyqtarë me transferime të përkohshme.

Në bazë të informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, informohemi se numri i çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë, është shpërndarë midis gjyqtarëve përkatësisht si më poshtë. Bashkëlidhur është edhe tabela e ngarkesës për secilin gjyqtar dhe nga ku rezulton që për vitin 2023, zoti {...} ka gjykuar 203 çështje.

Pranimi i kësaj kërkesë jo vetëm mbron një interes të dyfishtë, të personit/magjistratit me të cilët ka të bëjë drejtpërdrejtë, si dhe në interesin publik të mos cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, por objektivisht ato do të mund të konsideroheshin në ekuilibër të drejtë dhe në përputhje edhe me vetë rolin kushtetues që ka në këtë rast Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Mbi sa më sipër, relatori i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë qëndrimin në detyrë të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe ne i propozojmë Këshillit të vendosë pranimin e kësaj kërkesë.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votimin e projektvendimit.



*Yllka Rupa*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Bledar Bajri*: Dakord.

*Albens Tabaku*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Violanda Theodhori*: Dakord.

*Emona Muçi*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit z. {...} deri në moshën 70 vjeç, konform Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 19.12.2024.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (kryetar)
2. ***Yllka Rupa*** (zëvendëskryetare)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
7. ***Albens Tabaku*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Violanda Theodhori*** (anëtar)

58

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 31.10.2024 (Pika 7)***

**Shënime:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje **znj. Irena Plaku**. Zonja Plaku u largua nga pika e katërt dhe nuk mori pjesë më në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).**
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.**
- 8. Artan Rama.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado).

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

**Ridvan Hado:** Faleminderit!

Znj. {...} ushtron detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

Më datë 09.09.2024, ka depozituar kërkesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor duke shprehur interesin për emërimin e përhershëm në pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pasi ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë.

Në kushtet kur zonja {...} ka shprehur interes për emërimin në pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli ka detyrimin që të bëjë emërimin në pozicion në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civilë gjyqësorë pasi të bëjë verifikimet nëse ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion.

Rezulton nga verifikimet se ka plotësuar dy kriteret, edhe të përgjithshme edhe të posaçme për pranimin në shërbimin civil, referuar dosjes personale të saj pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Duke qenë se ka depozituar kërkesën në datën 09.09.2024, protokolluar në të njëjtën datë në Këshill me nr. {...}, në të cilën shpreh interesin si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Këshilli pra ka detyrimin për emërimin në pozicion, siç thashë, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish.

U bë verifikimi i organikës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, lidhur me organikën dhe numrin e ndihmësve ligjorë pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Nga informacioni i përcjellë në rrugë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se:

- referuar të dhënave mbi Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, rezulton se njësia është e përbërë nga 6 (gjashtë) pozicione sipas strukturës organizative, 3 (tre) pozicione sipas organikës në fakt, dhe 3 (tre) pozicione janë vakante;

- referuar të dhënave mbi Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, rezulton se kjo njësi është e përbërë nga 13

60

(trembëdhjetë) pozicione sipas strukturës organizative, 9 (nëntë) pozicione sipas organikës në fakt, përfshirë dhe znj. {...} dhe 4 (katër) pozicione vakante.

Bazuar në kushtet dhe nevojat që ka Gjykata Administrative e Apelit, referuar ngarkesës së çështjeve, stokut dhe numrit të magjistratëve efektivisht në detyrë si dhe bazuar në të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit aktual të kandidatit, vlerësohet pranimi në shërbimin civil, për pozicionin ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, gjykatë në të cilën, znj. {...} ushtron detyrën nga viti 2015.

Duke qenë se znj. {...} plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në shërbimin civil, në kushtet kur ajo është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të saj aktual për të cilin përmbush kriteret, si dhe kur aktualisht ushtron funksionin pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, vlerësohet se duhet të pranohet në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe të Administrimit, në mbledhjen e datës 29.10.2024, bazuar në pikën 135, Seksioni C, Kreu XI të vendimit 424/2020, kontrollon plotësimin e verifikimeve të kryera nga relatori, duke konsideruar se procedura për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe të kriterëve të veçanta për pozicionin e kërkuar, është e plotë, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit, mbi pranimin e znj. {...} në shërbimin civil gjyqësor dhe caktimin e saj në pozicionin e sipërcituar.

Faleminderit!

*Ilir Rusi*: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado):

8.1 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

8.2 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

8.3 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

8.4 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

8.5 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

8.6 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***



*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi (kryetar)*
- 2. Yllka Rupa (zëvendëskryetare)*
- 3. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 4. Gentiana Muçaj (anëtare)*
- 5. Ridvan Hado (anëtar)*
- 6. Bledar Bajri (anëtar)*
- 7. Albens Tabaku (anëtar)*
- 8. Markelian Koça (anëtar)*
- 9. Violanda Theodhori (anëtar)*
- 10. Emona Muçi (anëtare)*

*Shënime:* Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje *znj. Irena Plaku*. Zonja Plaku u largua nga pika e katërt dhe nuk mori pjesë më në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luan Dibra (në sallë), Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).*
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 8. Artan Rama.*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Ridvan Hado):

8.1 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

8.2 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

8.3 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

8.4 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

8.5 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

8.6 Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

***Ilir Rusi:*** Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve po nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, relator është z. Hado, në lidhje me pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}. Fjala për relatorin z. Hado.

***Ridvan Hado:*** Faleminderit!

Në vijim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli ka vendosur kualifikimin e gjashtë kandidatëve fitues dhe lejimin e tyre për të ndjekjen e programit të formimit fillestar të Shkollës së

66

Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, të z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Në përfundim të programit të formimit fillestar, të vitit të sipërcituar, ka rezultuar se kandidatët kanë marrë më shumë se 70% të pikëve në total që është numri minimal për pranimin e tyre në shërbimin civil: të z. {...} 85.68 pikë, znj. {...} 81.95 pikë, znj. {...} 80.18 pikë, znj. {...} 79.19 pikë, znj. {...} 77.91 pikë dhe z. {...} 77.30 pikë (duke përcjellë dhe aktet në Këshill me shkresën nr. {...} prot., datë 01.08.2024, për vijimin e procedurave).

Këshilli, referuar vendimit nr. 424/2020, ka përcaktuar se për kandidatët të cilët kanë ndjekur programin e formimit fillestar, do të pranohen në shërbimin civil nëse plotësojnë kushtin e kalimit me sukses të këtij programi në Shkollën e Magjistraturës.

Sa më sipër, në mbledhjen plenare të datës 01.10.2024, Këshilli, ka miratuar vendimet duke vendosur kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të 6 kandidatëve për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Në vijim të procedurave, Këshilli bazuar ndër të tjera dhe në parashikimet e vendimit të tij nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, me vendimin nr. 552, datë 01.10.2024 ka vendosur:

1. Shpalljen e 6 (gjashtë) vendeve vakante, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë:

Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm - 3 (tre) pozicione për ndihmës ligjor;

Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit - 3 (tre) pozicione për ndihmës ligjor;

Më datë 01.10.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin 424/2020, 6 kandidatët, në rrugë elektronike, u njoftuan: - për të drejtën që kishin për të përzgjedhur dhe shprehur interesin për t’u caktuar në njërin nga pozicionet e shpallura vakante, me vendimin e mësipërm, brenda 1 (një) dite nga marrja e njoftimit.

Po në rrugë elektronike, brenda afatit ligjor, kandidatët kanë shprehur interesin e tyre për caktimin në pozicionin si ndihmës ligjor konkretisht:

Z. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Z. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në referim të nenit 64, pika 7, të Ligjit nr. 98/2016 “Për pushtetin gjyqësor”, i ndryshuar: “7. Kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë kandidatë detyrohen të kthejnë të gjithë shpërblimin e marrë brenda tre vjetëve në rast se kandidati përjashtohet ose largohet nga shkolla ose në rast se kandidati nuk kërkon të caktohet në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i arsimimit në Shkollën e Magjistraturës”, rezultoi se 6 (gjashtë) kandidatët kanë depozituar pranë Këshillit, kërkesat për emërimin dhe trajtimin financiar.

Referuar kërkesave të sipërcituara për shprehje interesi për emërimin/caktimin në pozicionin ndihmës ligjor në gjykatat si më sipër, dhe pas verifikimit se kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin e tyre në këto pozicione, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civil gjyqësor.

Lidhur me emërimin e ndihmësit ligjor, neni 59, pika 3 e Ligjit për Pushtetin Gjyqësor, parashikon se ajo kalon nëpërmjet një procedure zgjedhjeje nga Këshilli të kandidatëve të cilët paraqesin kërkesë. Në një rast të tillë Këshilli do të duhet të mbajë në

konsideratë: a) renditjen në listën e kandidatëve; b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) [...]”, etj.

Kjo procedurë parashikohet nga ligji dhe mbahet në konsideratë në rastin kur kemi më shumë kandidatë sesa vende vakante të lira.

Ndërkohë që në rastin konkret, të caktimit në pozicion, për z. {...}, (i cili ka shprehur interes pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por duke qenë se është renditur i fundit në listën e pikëzimit nga shkolla, pozicion i lirë mbetet pranë Gjykatës Administrative të Apelit) procedura e zgjedhjes e parashikuar nga pika 3 e nenit 59, të ligjit të sipërcituar nuk ka vend për t’u zbatuar, pasi siç u theksua më lart, Shkolla e Magjistraturës, me vendimin nr. 29, datë 03.07.2024 “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjorë në Programin e Formimit Fillestar”, e ka renditur atë, të gjashtin në listën e kandidatëve, me 77.30 pikë.

Përmbushja e preferencave të deklaruara shkon në raport me renditjen e tyre:

Z. {...}, pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (sikurse ka shprehur interesin).

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (sikurse ka shprehur interesin).

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (sikurse ka shprehur interesin).

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (sikurse ka shprehur interesin).

Znj. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (sikurse ka shprehur interesin).

Z. {...} – pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (ndërkohë që ka shprehur interesin për Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por duke qenë se është renditur i fundit në listën e pikëzimit nga shkolla, pozicion i lirë mbetet pranë Gjykatës Administrative të Apelit).

Në këto kushte, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, vlerësoi se kandidatët duhet të pranohen në shërbimin civil gjyqësor dhe i propozohet mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratimi i 6 projektvendimeve, të cilët titullohen:

Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Struktura e projektvendimeve është si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit, parashikohet pranimi në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve dhe caktimi në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatës përkatëse.

Në pikën 2 të projektvendimit është përcaktuar fillimi i efekteve juridike të vendimit, përfshirë dhe ato financiare, menjëherë.

Në pikën 3 të projektvendimit, përcaktohet njoftimi i vendimit, kandidatëve dhe gjykatës përkatëse ku do të caktohen në pozicion kandidatët, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për qeverisjen” i ndryshuar.

Në fund parashikohet hyrja në fuqi e tij që është në mënyrë të menjëhershme dhe

botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, hedhim në votim projektvendimin “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} [...]”.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Bledar Bajri:*** Dakord.

***Albens Tabaku:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Violanda Theodhori:*** Dakord.

***Emona Muçi:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë në votimin e projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} [...]”.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.



**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} [...]”.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} [...]”.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} [...]”.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Nuk dëgjohet.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me projektvendimin “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} [...]”.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Illir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 31.10.2024)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin/caktimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 12:34.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (kryetar)
2. ***Yllka Rupa*** (zëvendëskryetare)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
7. ***Albens Tabaku*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Violanda Theodhori*** (anëtar)

77

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 31.10.2024 (Pika 9)***

**Shënime:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje **znj. Irena Plaku**. Zonja Plaku u largua nga pika e katërt dhe nuk merr pjesë më në vijimin e mbledhjes.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
- 4. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Luan Dibra (në sallë), Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Arben Lila, përfaqësues EU4Justice (në sallë).**
- 8. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.**
- 9. Artan Rama.**
- 10. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin/ caktimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Ilir Rusi:** Sipas këtij rendi dite, vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për zëvendësimin/ caktimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe

Buxhetit. Relatimi do të bëhet nga Drejtori administrimit gjyqësor dhe teknologjisë, z. Greca.

***Kelment Greca:*** Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 pika 2, dhe 92 pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, është organi i ngarkuar me kompetencën për caktimin e anëtarit në Bordin drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Ky detyrim është përmbushur nga Këshillit, me vendim nr. 34, 28.01.2021, duke caktuar anëtare prej KLGJ-së znj. {...}, njëkohësisht Kryetare të Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Me vendimin nr. 625, 22.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur: “Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}. Përfundimi i qëndrimit në detyrë të znj. {...} më datë 17.10.2024.”

Sa më sipër, gjendur përpara faktit të deklarimit të mbarimit të mandatit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, Këshilli, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM-ja nr. 972, konkretisht neni 9/a, duhet të caktojë në mbledhjen plenare të tij, anëtarin/kryetarin e Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, vlerësohet e nevojshme vendimmarrja e Këshillit, për zëvendësimin/caktimin e Kryetarit të Bordit, i cili ka këto detyra:

- a) përgatit, thërret e drejton mbledhjet e Bordit;
- b) mbikëqyr mbështetjen e nevojshme administrative, financiare dhe logjistike nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për funksionimin e qendrës;
- c) në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe strukturën e përhershme të qendrës, siguron mbështetjen administrative dhe organizative për funksionimin e Bordit;
- ç) siguron që mbledhja e Bordit të regjistrohet në sistemin audio dhe një përmbledhje e procesverbalit të mbledhjes së Bordit bëhet publike në faqen e internetit të qendrës;

- d) drejton procesin e shpërndarjes së detyrave ndërmjet anëtarëve të Bordit;
- dh) drejton procesin e hartimit e të zbatimit të planit vjetor të Bordit dhe siguron publikimin e tij;
- e) siguron dorëzimin e projektbuxhetit të qendrës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda afatit dhe merr pjesë në diskutimet e Kuvendit për buxhetin e sistemit gjyqësor;
- ë) siguron dokumentimin e mbledhjes së Bordit e mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;
- f) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me vendim të Bordit ose nga legjislacioni në fuqi.”

Menjëherë me caktimin e tij nga KLGJ-ja, kryetari i Bordit duhet të vijojë ushtrimin e veprimtarisë duke marrë masat e duhura për të garantuar nga KLGJ-ja, mbështetjen e nevojshme organizative dhe administrative nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për realizimin e funksionit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe të Bordit Drejtues.

Në këto kushte Komisioni për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin, i propozon Këshillit miratimin e projektvendimit “Për caktimin e anëtarit të Këshilli Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga një pikë.

Pika 1, parashikon caktimin z. Ilir Rusi si anëtar, njëkohësisht dhe Kryetar në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Në fund, parashikohet hyrja në fuqi e tij që është në mënyrë të menjëhershme, po ashtu edhe detyrimi për publikim në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Ilir Rusi:* Faleminderit zoti Greca!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)



Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Bledar Bajri*: Dakord.

*Albens Tabaku*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Violanda Theodhori*: Dakord.

*Emona Muçi*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për zëvendësimin/ caktimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e z. Ilir Rusi si anëtar, njëkohësisht dhe kryetar në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Ilir Rusi*: Në vijim të kësaj mbledhjeje, çështja tjetër për shkak të karakterit të saj është me dyer të mbyllura.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**